



FEDERATA E FAMILJES PËR PAQE BOTËRORE DHE BASHKIM

Adresa: Zeki Shulemaja K2/3 5111836-7, PRISHTINË

Cel. 049-379-931 email: ffpbb.prishtine@gmail.com; www.federataefamiljes.org



Raport i aktiviteteve të muajit Prill

Të dashur vëllezër e motra, përshëndetje nga larg! Dëshirojmë që të ndajmë me ju aktivitetet që janë zhvilluar në Prishtinë gjatë muajit Prill. Shpresoj të jenë burim frymëzimi për ju, e të krijojnë ndjesinë e lutjes në zemrat tuaja për ne, për tu lidhur me njëri-tjetrin edhe pse larg.¹

Këtë herë raporti nuk do fillojë shumë i gëzueshëm, pasi do raportohet për largimin e grupit të STF nga Kosova. Ata u larguan më 02 Prill për në Rumani. Largimi i tyre u prit dhimbshëm nga të gjithë ne, por gjithsesi ne mundëm të bëjmë Vigil Prayer dhe një piknik së bashku me ta duke i përcjellë sa më mirë mundëm.

Leximi, lutjet, video-ja, eksperincat personale, loja e emrave, krijuan harmoni dhe atmosferë fantastike gjatë Vigil Prayer. Të gjithë që morën pjesë shprehën kënaqësi që mundën të përjetojnë ndjesi të veçanta gjatë asaj nate. Foto harruam të bëjmë, por ishim 17 vëllezër e motra që morëm pjesë.

Ndërkohë në 31 bëmë një piknik të bukur.



Në ditën e Autizmit më 02.04.2016, ne bashkëpunuam me Shoqatën e Autizmit të Kosovës, duke i mbështetur ata si vullnetarë në organizimin e një marshimi në sheshin e Prishtinës dhe më pas në koncertin e zhvilluar te Teatri me fëmijët autikë. Të rinjtë shprehën kënaqësi që mundën të marrin pjesë në një aktivitet të tillë, duke vlerësuar se diferencat dhe kufizimet janë të kapërcyeshme nëse bashkëpunojmë.



Në datën 6 Prill u organizua edhe një aktivitet tjetër shumë i bukur, u dhurua gjak pranë spitalit të Prishtinës. Quhet i bukur pasi e tillë ishte atmosfera e krijuar nga stafi mjekësor që na mirëpriti, dhe nga të rinjtë që morën pjesë.



¹ Shënim: Përpiqem të shkruaj sa më shpesh për pwrpjekjet tona në ndihmë të Providencës, pasi kur kam qenë në Gradisht, mezi i kam pritur raporte të tilla, e kam përjetuar gëzim e lidhje shpirtërore me të gjithë, nëpërmjet tyre.



FEDERATA E FAMILJES PËR PAQE BOTËRORE DHE BASHKIM

Adresa: Zeki Shulemaja K2/3 5111836-7, PRISHTINË


Cel. 049-379-931 email: ffpbb.prishtine@gmail.com; www.federataefamiljes.org



Pas seminarit të W-CARP ku morën pjesë 19 persona (nga këta 12 të rinj), organizuam një „Post Seminar”, në takim të CARP ditën e Mërkurë. Të gjithë që morën pjesë diskutuan rreth seminarit, duke shprehur përshtypje shumë pozitive (pasi nuk lanë pa komentuar edhe vështirësitë e fjetjes, apo ushqimit).



Gjithashtu një lajm tjetër shumë i gëzuar është që festuam dy ditëlindje këtë javë: Ditëlindjen e Norës, ku u kënaqëm shumë, si dhe ditën e lindjes shpirtërore të Elza Kantarxhiu. Ajo e priti shumë mirë leksionin e Ardhjes së Dytë, e pranoi se e kishte kuptuar deri diku mesazhin final, pas leximit të librit të Autobiografisë së Babait të Vërtetë. Ajo qëndroi me ne atë mbrëmje deri në 10:00 të mëngjesit dhe ne shpresojmë të qëndrojmë përgjithmonë. ☺. Gjithashtu me keqardhje përcollëm edhe vëllain tonë, Artan Kurtin, i cili vendosi të mbyllë misionin në Kosovë. Fatmirësisht Qendra vazhdoi të ndjehet plot nga prezenca e dy motrave të mrekullueshme nga Koreja. Këto janë gjërat më kryesore që kanë ndodhur gjatë muajit, por misioni është i mrekullueshëm, ka plot surpriza, ndjesi e ndodhi të cilat nuk përmblihen dot në një raport ☺. Zoti ju bekoftë!



Me shumë dashuri, Savjola.